




Pranimi / Dostizuar Received / Delivered		13. 09	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Org. / Unit	Nr. Prot Pr. No	Shlyerja Protog. Appendix		Sasia Kolicina Quantity	
SKDMSHICK	5377/2022			1/4	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.678/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.678 të datës 01.08.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: kundër

Vendimin KA.nr.22/2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 04.07.2022, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.09.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.678/2022 e datës 01.08.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi KA.nr.22/2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 04.07.2022.

A r s y e t i m

Ankuesja sipas shkresave të lëndës e punësuar në Këshillim Prokurorial të Kosovës, ka parashtruar ankesë me datë 01.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimin KA.nr.22/2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 04.07.2022.

Ankuesja pretendon se Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit më shifër KA.nr.22/2022 të datës 04.07.2022 përmes të cilit ankuesit ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e datës 17.06.2022, ka



vepruar në kundërshtim dispozitat e Ligjit Nr.05/L-149 për Shërbimin Civil të republikës së Kosovës, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative njëkohësisht ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa e njëjta kërkon që Këshilli t'i aprovojë ankesën për ngritjen/harmonizimi e koeficientit nga dhjetë (10) në gjashtëmbëdhjetë pikë tetë (16.8) ndërsa të obligojë organin e punësimit Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të nxjerr aktin e kërkuar nga pala.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 11.08.2022, me numër protokollit 4652/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Këshilli Prokurorial i Kosovës, ndërsa me datën 23.08.2022 me numër protokollit 4914/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 01.08.2022 me numër protokollit 4436/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesja Kërkesën për shqyrtim të harmonizimit të koeficientit e datës 13.04.2022; Kërkesën e përsëritur për shqyrtimin e harmonizimit të koeficientit si dhe kompensimit të diferencës së pagës në mënyrë retroaktive e datës 18.05.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 19.05.2022; Vendimin KA.nr.22/2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 04.07.2022; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Kryeprokurorit të Shtetit i datës 04.09.2013 me numër:965/2013; Akt emërimit e ankueses të datës 04.09.2013; Kontratën e punës së ankueses e datës 01.01.2011; Konkursin për pozitën Menaxher i Zyrës për Trajnime; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit Kryeprokurorit të Shtetit i datës 04.09.2013 me numër:964/2013; Akt emërimit e nëpunësit civil B.K i datës 04.09.2013; Akt emërimit e nëpunësit civil B.K i datës 04.09.2014; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 01.10.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 30.12.2021; Kërkesën për përgjigje e datës 11.08.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 23.08.2022; Vendimin e Kryetarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 18.05.2012; Vendimin e Kryetarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 10 (muaji i padukshëm) viti 2014; Ankesën e ankues të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës e datës 17.06.2022; E-mailin e datës 16.08.2022 dërguar nga Sh.H për B.L; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Koordinatorë për trajnime në Këshillin Prokurorial të Kosovës; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Koordinator për Komisione të Përhershme të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me gjatë administrimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesja sipas aktit emërimit të datës 04.09.2013 është e punësuar në Këshillin Prokurorial të Kosovës në pozitën e punës "Koordinatorë e Zyrës për Trajnime në NJSHPP", ndërsa me datë 13.04.2022 ka parashtruar kërkesë për shqyrtimin e harmonizimit të koeficientit tek Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të përgjithshëm të Sekretarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kërkesë të cilin e ka përsërit me datë 18.05.2022 duke plotësuar edhe me kërkesën për kompensim të diferencës në pagë në mënyrë retroaktive. Me datë 19.05.2022 Njësia e Burimeve Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës i ka kthyer përgjigje ankueses në kërkesën e datës 13.04.2022 dhe atë të datës 18.05.2022 me arsyetimin se, citoj: "njoftoheni se jemi në proces të ri-



*organizimit të brendshme dhe sistematizimit të administratës në Sistemin Prokurorial të Kosovës dhe të gjitha kërkesat do të trajtohen gjatë këtij procesi”.*

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 17.06.2022 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kundër akt emërimit me shifër ZBNJ/D-065/2013 të datës 04.09.2013 si dhe Vendimit me numër protokolli: DP-188/2013 të datës 2013, ndërsa Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 04.07.2022 ka nxjerr Vendimin më numër KA.nr.22/2022 përmes të cilit ankesën e ankueses e ka hedhur poshtë si të pasafatshme me arsyetimin se ankesa e ankueses e datës 17.06.2022 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 dhe neni 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”* si dhe nenin 4 paragrafi 1 dhe neni 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: *“Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”*, dhe ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes Vendimit më numër KA.nr.22/2022 të datës 04.07.2022 ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e lartcekura të ligjit pasi që ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, ndërsa pretendimet ankimore të ankueses nuk janë të bazuara ngase aktet të cilat ankuesja i ka goditur me ankesën datës 17.06.2022 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve Ankesave, gjegjësisht akt emërimit me shifër ZBNJ/D-065/2013 të datës 04.09.2013 si dhe Vendimin me numër protokolli: DP-188/2013 të datës 2013 për të cilat pretendon se kanë qenë të kundërligjshme asaj kohe dhe mbi këtë bazë kërkon edhe harmonizimin e koeficienti respektivisht ngritjen nga dhjetë (10) në gjashtëmbëdhjetë pikë tetë (16.8) të koeficientit dhe kompensimin në mënyrë retroaktive, janë akte të cilat ankuesja i ka pranuar si të mirëqena para shumë vitesh dhe asaj kohe nuk ka ndërmarr asnjë veprim procedural administrativ, ndërsa tani kanë kaluar të gjitha afatet procedurale të përcaktuara si në nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe ligjit material për goditjen tyre në procedurë administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.678/2022

Flakron GASHI

  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Arkivoit të KPMSHCK- së.

